



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 2, datë 31.01.2018

PËR MIRATIMIN E EMËRIMIT TË BANKËS AMERIKANE TË INVESTIMEVE SI DEPOZITAR TË FONDIT TË INVESTIMIT “CREDINS PREMIUM”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 42, 50 pika 1 dhe 5, të Ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për Sipërmarrjen e Investimeve Kolektive”, me propozim të Departamentit të Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Në mbështetje të neneve 42 dhe 50, pika 1 dhe 5 të Ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, Shoqëria “Credins Invest”, sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, ka njoftuar me shkresën nr. 1562 prot., datë 24.11.2017, për ndërprerjen e marrëdhënieve kontraktuale me First Investment Bank dhe vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale me Bankën Amerikane të Investimeve dhe lidhjen e Kontratës së Shërbimit Depozitar.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e emërimit të Bankës Amerikane të Investimeve si depozitar të Fondit të Investimit “Credins Premium”.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI